

## **TAKIMI ME MINISTRIN E DIASPORËS Z. IBRAHIM MAKOLLI**

Më 18 qershor 2013 në lokalet e konsullatës së Kosovës në Gjenevë është mbajtur një takim ndërmjet Ministrit të Diasporës së Kosovës z. Ibrahim Makolli dhe Kryesisë së Komunitetit Shqiptar të Gjenevës.

Ali Mehmet, kryetar i komunitetit e njoftoi ministrin për disa aktivitete të zhvilluara që nga themelimi e këndej, duke i veçuar përpjekjet dhe përgatitjet për krijimin e një spoti televiziv, që do të sensibilizonte prindërit shqiptar për t'i dërguar fëmijët e tyre në mësimin plotësues të gjuhën shqipe dhe që ky spot të transmetohet në televizionin publik të Kosovës.

Gjithashtu e informoi ministrin në lidhje me reagimin që komuniteti ynë e ka bërë me rastin e mbajtës së një tubimi serbo-sirian, kundër-shqiptar, me titull tendencioz "[Trafikimi i organeve dhe armët kimike në konfliktet në Siri dhe Kosovë](#)", që u mbajt më 12 qershor 2013 në lokalet e Universitetit të Gjenevës. Si kundërpërgjigje është propozuar që edhe ne ta organizojmë një konference e cila e trajton luftën në Kosovë të shkaktuar nga regjimi serb me tematika si: dhunimi i grave, krimet mbi fëmijë, personat e pagjetur apo të ngjashme, që të neutralizojmë imazhin e keq që po e mbjell Serbia dhe që po e godet çdonjërin nga ne.

Ministri Makolli e përgëzoi themelimin e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës duke u shprehur i gatshëm për bashkëpunim dhe bashkëveprim. Lidhur me spotin televiziv na siguroi se e përkrahë këtë iniciativë dhe se pas përfundimit të tij do të angazhohet që ai të transmetohet falas nga televizioni ynë publik RTK, sepse është me interes të gjerë publik. Ky transmetim do të bëhet nga fundi i gushtit dhe gjatë muajit shtator.

Edhe lidhur me organizimin eventual të një konference apo tryeze, si kundërpërgjigje ndaj asaj serbo-siriane, ministri Makolli na premtoj ndihmë.

Ministri Makolli na informoi se ministria e diasporës ka shumë plane për bashkëpunim me mërgatën tonë, por i veçoj dy nga më të rëndësishmet për momentin ndjekja e mësimit plotësues në gjuhën shqipe dhe regjistrimi i mërgatës.

Ministri Makolli iu përgjigj edhe shumë pyetjeve nga të pranishmit,

Për sigurimin e obligueshëm për automjete në kufirin e Kosovës tha se është bërë dy here kërkesa në organizatën e kartonit të gjelbër, por për të qenë anëtare e barabartë me vendet tjera është e nevojshme që Kosova të jetë anëtare e OKB-së. Tentativa e re është në vazhdim e sipër.

Është biseduar edhe për sigurimet sociale, pasi që shumë persona janë të prekur nga mungesa e marrëveshjes Zvicër-Kosovë në këtë fushë. Për t'u

arritur kjo marrëveshje Zvicra kërkon miratimin e tre ligjeve nga Kuvendi i Kosovës, dy prej të cilëve janë miratuar ndërsa mungon i treti, ai i sigurimeve. Sidoqoftë, vërehet edhe mungesa e vullnetit politik nga ana e Zvicrës, pasi që për disa marrëveshje tjera që janë në interes të Zvicrës, nuk kërkohet asnjë kusht, siç është psh. marrëveshja për riatdhesim dhe ri-integrim. Janë të formuara disa grupe punuese që po mundohen ta zhblokojnë situatën.

Lidhur me investimet ministri na ka informuar se te gjitha makineritë e destinuara për prodhimtari, që hyjnë në Kosovë janë te liruar nga dogana dhe tatimi, kurse 27 nga komunat i kanë identifikuar fushat e veprimtarisë, sidomos ato në bujqësi dhe blegtori, sikur më të dobishme për investitorët. Po ashtu në informoi se prodhimet nga Kosova për në bashkimin Evropian mund të eksportohen pa doganë dhe pa taksa tjera.

**Nasuf Nuhiu**